



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC  
KESHILLI

Nr. 209/11 Prot.

Pogradec, më 28 . 01 .2025

VENDIM

Nr. 10 , datë 27 . 01 .2025

**PËR AKORDIMIN E NDIHMËS FINANCIARE Z. ERTON BAÇI, LAGJA  
4, BASHKIA POGRADEC, PËR SHKAK TE DËMTIMIT TE BANESES  
NGA RENIA E ZJARRIT**

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 8, të pikës 1 të nenit 29, të ligjit nr. 139/2015, “Për Veteqeverisjen Vendore”, të neneve 4, 7 dhe 41, të ligjit nr. 45/2019, datë 18.07.2019 “Për Mbrojtjen Civile” dhe të kapitullit III të V.K.M Nr. 329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerezore”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDOSI:**

1. Miratimin e kërkesës së Bashkisë Pogradec për mbështetje financiare të z.Erton Baçi, për dëmtimin e banesës nga rënia e zjarrit në datën 04.01.2025
2. Miratimin e dokumentacionin tekniko-ligjor të hartuar nga Bashkia Pogradec.
3. Ti akordojë familjes së shtetasit z.Erton Baçi ndihmën emergjente në vlerën prej **1,037,639.9Lek** nga buxheti i Bashkisë Pogradec, fondi i emergjencave civile i destinuar dhe miratuar nga Këshilli i Bashkisë Pogradec për vitin 2025.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Emergjencave Civile, Strehimi dhe Administrimit të Tokës Bujqësore në Njësitë Administrative,



si dhe Drejtoria e Administrimit të Çështjeve Ekonomike dhe Financiare të Bashkisë Pogradec.

5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes:

KRYETARE E KËSHILLIT

Manjola KAMOLLI



1. Miratuar me 20 vota

2. Vota Pro 20

3. Vota Kundër 0

4. Vota Abstenim 0

5. Zbardhur më date 28.01.2025